



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Datë: 01.02.2019

Pyetjet nga Aplikantët/Përgjigjjet nga MZHR-ja lidhur me PZHRB 2019

1. Kemi hapur biznesin gjatë muajit Janar 2019, sipas Udhëzuesit për Aplikante ne na bënë që të kualifikohemi për LOT 2 "si ndermarrje egzistuese deri ne 2 vjet", sido që të jetë për arsye të historikut të shkurt ne si biznes deshëm ta konfirmojm se a kemi të drejtën e aplikimit në këtë fazë përkatësisht LOT 2 pavarsisht historikut të shkurtë e cila mund të pasqyrohet gjatë aplikimit për grant edhe në këstet TM nga ATK për vitin e fundit fiskal?
- *PO keni drejtë të aplikoni për Lot 2.*
2. Nëse janë dy patrner të biznesit për LOT 2, në sistem a paraqet problem që të regjistrohemi njëri dhe të aplikojm?
- *Nëse është fjala për një biznes me dy aksionar mundet njëri prjj përfaqësuesve të autorizuar të aplikojë, kurse nëse është fjala për dy biznese nuk mund të aplikojnë dy biznese për një projekt (grant).*
3. Shuma e Grantit për LOT 2 është deri në 15,000 euro, a mundet që projekti të jetë 20,000 euro Ministria me financu 15,000 euro (75%) dhe vetëfinancim 5,000 euro (25%)?
- *PO.*
4. A duhet që ti marrim ofertat nga biznest që i ofrojn ato makineri/paisje për relaizmin e projektit dhe ti ngarkojm në sistem?

- *PO, duhet të bashkangjitet një ofertë në sistemin SMAED gjatë aplikimit për vlerën e projektit që përfshinë edhe bashkëfinancimin.*
- 5. A janë obligative që të ngarkohen dokumentet në sistemin SAMED Online si:
Diploma, certifikata dhe Foto?
 - *Diplomat e shkollimit JO, por certifikatat e biznesit dhe Nr. Fiskal PO.*
- 6. Jam një biznes i ri ferme për trashjen e bikave, deshta me apliku për propozimin e fundit, unë e kam biznesin e regjistruar edhe certifikatën por që 1 muaj nuk kam bërë pagesa në ATK, tash me intereson të di tek cili Lot me apliku në Lot 1 apo 2?
 - *LOT 2, por sigurohu që projekti i juaj është i kualifikuar për shkak se ky program nuk financon biznese të natyrës së tillë.*
- 7. Unë si ndërmarrës i cili jam në treg afërsisht 2 vite merrem me xhirimin, zhvillimin e video reklamave, filmave dokumentare, fotografime të ndryshme, krijimin të llogove, brendeve etj. deri me tani kam investuar afërsisht 40,000 euro në këtë biznes. A kam përkraje apo a mundem të aplikoj për blerjen e pasijeve teknologjike si psh kamera, kompjuter, aparate etj?
 - *PO.*
- 8. Jam i interesuar se a mund të aplikoj në thirrjen për grante nese ideja ime është që të ndërtoje lojëra për fëmijë dhe me atë mund të ofroje shërbime për katering dhe shërbime të tjera për ditëlindje?
 - *Shiqo udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4, 2.6 dhe 2.7, inventari si karriga, tavolina apo dollape si dhe të ngjajshme nuk janë shpenzime të kualifikueshme.*
- 9. Pyetja ime është se a paraqet ndonjë problem nese une investoj me vleren mbi 40% (pra në rast të përfitimit të grantit rreth 25000 euro, a paraqet problem nëse une e bashkëfinancoj pjesën e mbetur 17000 euro)?
 - *Shuma e lejuar e bashkëfinancimit duhet të jetë brenda këtyre përqindjeve 10% - 40%.*
- 10. Nuk po kuptoj a duhet me ofru ofertat në ministri apo duhet edhe oferten + me ju shpre me dokumente brenda buxhetit që është paraqit LOT 2?
 - *Aplikimi bëhet online në sistemin SMAED shiqo udhëzuesin për aplikim janë sqarimet për secilin Lot.*
- 11. A duhet se bashku me planin e veprimit të përgaditet biznes plani i kompanisë dhe te pjesa e bashkëfinancimit është cekur që bashkëfinancimet në natyrë nuk përkrahen apo bashkëfinancohen, a nënkupton kjo që kallboja

përmes së cilës ne e shpërndajmë rrjetin dhe që është si pjesë përcjellëse e softuerëve nuk bashfinancohet apo si qëndron çështja?

- *Vetëm formularët e caktuar sipas udhëzuesit duhet të plotësohen, shiqo udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4, 2.6 dhe 2.7.*

12. Oferta për pajisje a mund të jetë edhe nga shtetet tjera sepse nuk ka mundësi tregu në Kosovë të ofrojë pasije të tilla për të cilat ne kemi nevojë (pra paisjet duhet të blihen jashtë Kosovës)?

- *Nuk keni kufizime se ku ta bleni paisjen, jeni të lejuar të bëni bjerjen në cilin do shtet që ju dëshironi.*

13. Lidhur me kërkesën tuaj për dokumentacion shtesë, konkretisht "Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt", ju lutem nëse mund të më njoftoni se a duhet të jetë e vulosur/nënshkruar, pasi që ofertat që po i pranojmë nga jashtë nuk kanë vule apo nënshkrim. A ka ndonjë kriter shtesë lidhur me këtë pikë, apo mjafton që oferta nga jashtë të jetë pa vule/nënshkrim?

- *Oferta mund të jetë me vule dhe nënshkrim, por gjithsesi duhet ti ketë kontaktet e ofertuesit në mënyrë që vlerësuesit të kenë mundësi të verifikojnë ofertën.*

14. Kompania ime është e regjistruar në vitin 2014 ku ka pas disa aktivitete, pastaj ka pauzuar dhe nuk ka pas transaksione. Duke filluar nga Shkurti 2019, kompania kalon në tatim real si sh.p.k. dhe ri-fillon aktivitetet, duke punësuar staf dhe shpenzime të tjera. Pyetja ime është, a me apliku si biznes i ri sipas LOT 1, apo si biznes ekzistues LOT 2 ose 3, pavarësisht që ka qenë pasive disa vite?

- *Për këtë thirrje merret për bazë data e regjistrimit të biznesit nga sistemi i ARBK-së, dhe ajo datë e përcakton në cilin Lot mund të aplikoni në rastin konkret Lot 3.*

15. Pasi që e kam parë thirrjen në uebfaqe të ministrisë dhe pas leximit të udhëzimit aty shkruante se përkrahen edhe "shërbimet komerciale". Kam një pyetje ju lutem, a mundeni me e specifiku se cilat veprimtari përfshihen në këtë "shërbime komerciale"?

- *Shiqo udhëzuesin për aplikantë pikën 2.6.*

16. Aplikanti me rastin e fitimit të grantit a është i detyruar që vetë të sigurojë mjetet dhe më pas të kthehen mjetet e investuara apo kjo rregullohet (zgjidhet) në ndonjë mënyrë tjetër?

- *Në rast se përfitoni grantin, MZHR do të paguaj pjesën e parë në avans varësisht se në cilin Lot aplikoni, kurse pjesa e dytë paguhet pas përfundimit të projektit.*

17. Ju lutem nëse mund të na njoftoni lidhur me kriteret e vlerësimit, se si do vlerësohen projektet. A ka ndonjë ndarje të pikëve në bazë të deklarimeve paraprake në ATK (p.sh, për LOT 2 dhe LOT 3) apo në kriteret tjera?
- *Vlerësimi do të bëhet sipas përmbushjes së kapitujve në formularët dhe shtojcat e publikuara, dhe publikimi i rezultateve do të bëhet në mënyrë transparente.*
18. Poashtu, a kanë të drejtë të aplikojnë përfituesit e kaluar nëse kanë qenë nga LOT 2, dhe tani të aplikojnë për LOT3? Apo nga Lot 1 për Lot?
- *JO, përfituesit nga skema e granteve PZHRB 2018 nuk kanë drejtë të aplikojnë në asnjë Lot.*
19. Bazuar në Udhëzues shkruan që këto Kosoto (të cekura më poshtë) janë të pa pranueshme kurse në SHTOJCA C1 po të njëjtat janë të listuara në tabel si të pranueshme. 2.7 Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysh për grantin
Kostot e pakualifikueshme:
- o Pagat dhe meditet;
 - o Shpenzimet e lëndës së parë;
 - Shpenzimet tjera operacionale (qiraja, rryma, uji etj.)?
- *Shtojca C1 nuk është shtojca e buxhetit për të cilin ju aplikoni për shumë të grantit, kjo shtojcë shërben për të paraqitur projeksionet financiare të biznesit që ju mendoni ta zhvilloni për vitet e ardhshme varësisht se për cilin Lot aplikoni.*
20. Ju lutem me sqaroni për Lotin 1, vlera maksimale e grantit a është 5,000 €, apo kjo vlerë përfshinë grantin dhe bashkëfinancimin e aplikuesit?
- *Shuma maksimale të cilën e financon MZHR për Lot 1 është 5,000.00 € pa përfshirë bashkëfinancim, nëse aplikoni për shumë maksimale atëherë vlera e projektit që përfshinë edhe bashkëfinancimin do të jetë mbi 5,000.00 €.*
21. Loti 3 – Nërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) Nga 15,000 € - 25,000 € - a nënkuptojmë se të drejtë aplikimi kanë vetëm ndërmarrjet e vogla me 10 - 49 punëtorë, dhe jo ndërmarrjet mikro, të mesme apo të mëdha?
- *Ashtu sic është përcaktuar me LIGJIN NR. 04/L-220, d.m.th. ndërmarrjet mikro dhe të vogla kualifikohen për këtë thirrje.*
22. Me këtë thirrje a mbështeten edhe veprimtaritë të fokusuar në ofrimin e shërbimeve si p.sh. Programimi, këshillimi apo edhe hoteleria?
- *Shiqo udhëzuesin për aplikantë pikën 2.6.*

23. Desha të pyes si është procedura për me apliku, a duhet me u regjistru së pari në sistemin e ruajtjes së dhënave?
- *Së pari regjistrohuni në sistemin SMAED, për më shumë info shiqo udhëzuesin për aplikim si dhe udhëzuesin e SMAED në uebfaqe të MZHR-së.*
24. Pyetja e parë është në lidhje me Lot 2 nëse është i hapur një biznes para 2 muajve dhe nuk ka vepruar, nuk ka patur qarkullim a lejohet me apliku në Lot 2. Nëse jo a lejohet me apliku në Lot 1 me ide dhe emër biznesi të ri?
- *Për këtë thirrje merret për bazë data e regjistrimit të biznesit nga sistemi i ARBK-së, dhe ajo datë e përcakton në cilin Lot mund të aplikon.*
25. Pyetja e dytë për lot 1 cilat a janë fushat e caktuar për përkrahje apo mvaret nga idet tona. P.sh a pranohen shërbimet në edukim apo profesione në aftësim të rinjëve dhe marketing? Gjithashtu a mund të më dergoni materialin e duhur për aplikim sepse nuk po mundem me gjetë?
- *Shiqo udhëzuesin për aplikantë i cili gjendet në uebfaqen e MZHR-së në linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/thirje-per-propozime-2019/>*
26. Jam nga Vitia, dua të aplikoj për Grantin në MZHR, por ka aty një dokument që më duhen disa sqarime "Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;" qka jan Infirmatatpercjellse sipas kerkesesave"?
- *Certifikata e regjistrimit të biznesit me faqet përcjellëse ku pasqyrohet se cilat veprimtari i ka të regjistruara biznesi si dhe kush janë pronarët etj.*
27. Partneri im dhe une jemi shtetas të Maqedonisë mirëpo jemi duke punuar në Kosovë gati 7 vite. Jemi rezident me lejeqëndrim të përkohshëm që e renovojme çdo vjet. Kemi hapur biznesin në Kosovë në nëntor të 2018 ku kemi edhe certifikatën e biznesit. Momentalisht jemi në inkubator të ICK. Pyetja është se a kemi të drejtë ne si shtetas të huaj dhe si rezident, mirëpo që kompania është e regjistruar në Kosovë të aplikojmë në këtë grant? Unë gjithashtu u mundova të regjistrohem online mirëpo nuk më lejonte edhe pse aty e lejonte të klikosh që je qytetar i huaj?
- *Së pari aplikoni për regjistrim në Sistemin SMAED me letërnjoftimin e RKS edhe nëse jeni rezident me lejeqëndrim te perkohshem por valid, pastaj MZHR ju ofron qasjen në këtë sistem.*
28. Ne edhe pse jemi biznes fillestar, a mund të aplikojme ne LOTIN 2? Pasi që kemi edhe certifikatën e biznesit edhe dokumenatcionin shtesë të kërkuar pasi që jemi

3 muaj duke operuar si biznes funksional atëher besoj që jemi të kualifikuar si biznes që jemi më pak se 2 vite sipas përshkrimit në udhëzues?

- *Për këtë thirrje merret për bazë data e regjistrimit të biznesit nga sistemi i ARBK-së, dhe ajo datë e përcakton në cilin Lot mund të aplikon.*

29. Ju lutem, për Lot 3, nëse në bashkangjesim aplikacionit tonë dëshmi të eksportit të produkteve, faturat e shitjes në shtetet e përendimit a lejohet kjo, si dhe a do kemi përparësi në vlerësimin e aplikacionit tonë dhe pyetja e dytë Formulari i aplikimit A2, për Lot 3, i shkarkuar nga SMEAD, duhet të bashkangjitet i plotësuar me anekset tjera, apo të plotësohet vetëm ajo që shfaqet në SMAED, me rastin e regjistrimit?

- *Formulari A2 plotësohet online kurse shtojcat tjera mund të shkarkohen dhe të plotësohen, dokumentet tjera mund ti bashkangjiteni.*

30. Ne jemi nje biznes i themeluar në vitin 2004 si NTP (biznis individual), por që në vitin 2017 kemi ndrruar formën juridike të biznesit duke hapur/transformuar biznesin në SHPK (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar). Jemi të interesuar të aplikojmë për LOT 3, por në certifikatën e biznesit që e kemi tani si SHPK, historia e biznesit tonë është më pak se 2 vite. Ju lutem na njoftoni si të veprojmë. Faleminderit paraprakisht?

- *Për këtë thirrje merret për bazë data e regjistrimit të biznesit nga sistemi i ARBK-së, dhe ajo datë e përcakton në cilin Lot mund të aplikon.*

31. Në udhëzuesin për aplikime nuk e kam gjetur informacionin në cilën mënyrë kryhet pagesa e mjeteve nëse aplikanti e fiton subvencionin dhe e nënshkruan kontratën?

- *Në rast se përfitoni grantin, MZHR do të paguaj pjesën e parë në avans varësisht se në cilin Lot aplikoni, kurse pjesa e dytë paguhet pas përfundimit të projektit.*

32. Për të aplikuar në këtë SKEMË në LOT 1, a duhet patjetër të jesh person fizik? A është në rregull që të aplikoj për LOT 1 një person i cili shtë aksionar në një kompani tjetër shpk dhe aplikon për LOT 1 për të hapur një kompani të re?

- *Për Lot 1 aplikojnë personat që nuk kanë biznes të regjistruar.*

33. Sipas Udhëzuesit për Aplikantët, të skemës se granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2019 për Lot 3, është specifikuar financimi për Ndërmarrje të vogla (mbi 2 vjet) nga 15,000 € - 25,000 €. Në lidhje me këtë, ju lutem na sqaroni se si e keni të definuar madhësinë e ndërmarrjeve për këtë

thirrje. Pra, a bëhet vlerësimi i madhësisë së ndërmarrjeve vetëm në bazë të numrit të të punësuarave si kriter i vetëm për klasifikim ashtu siç parashihet edhe me ligjet në fuqi apo merret parasysh edhe qarkullimi vjetor i ndërmarrjes?

- *Kjo thirrje vlen për Ndërmarrjet mikro dhe të vogla sipas klasifikimit të ndërmarrjeve me LIGJIN NR. 04/L-220.*

34. Po ju shkruaj për Lot 1 Kam një pyetje "Oferta për makinerine apo pajisjet/ shërbimet e planifikuar në projekt" a është obligative gjatë aplikimit?

- *PO.*

35. Kam shpreh dëshirën të aplikoj për grant - Lot 1 - Startup, a keni mundësi të më udhëzoni më shumë rreth dokumenteve që nevojiten për të aplikuar. Duhet ti plotësoj shtojcat A, B, C, D, E dhe si dokumente shtesë duhet ta bashkangjiti kërkesën për makinerinë apo pajisjet. A më nevojitet ndonjë dokument tjetër?

- *Shiqo udhëzuesin për aplikantë i cili gjendet në uebfaqen e MZHR-së në linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/thirrje-per-propozime-2019/>*

36. Me intereson të informohem në lidhje me grantet nga MZHR 2019, lidhur me financimin, a duhet që biznesi paraprakisht të siguroj mjetet financiare për realizimin e projektit edhe pastaj të bëhet pagesa sipas % nga MZHR, apo mënyra tjetër që MZHR të jetë financuese direkte për pjesë që i takon?

- *Në rast se përfitoni grantin, MZHR do të paguaj pjesën e parë në avans varësisht se në cilin Lot aplikoni, kurse pjesa e dytë paguhet pas përfundimit të projektit.*

37. Unë i përkas kategorisë Lot 1 - Projekte të reja biznesi (ndërmarrës të rinjë), më saktësisht dua të ju pyes a mundem të aplikoj për grante që të hap biznes për rrobaqepse, se për momentin biznes nuk kam?

- *PO*

38. Pytja e parë është në lidhje me Lot 2 nëse është i hapur një biznes para 2 muaj dhe nuk ka vepruar nuk ka patur qarkullim a lejohet me apliku në Lot 2, nëse jo a lejohet me apliku në lot 1 me ide dhe emer biznesi të ri?

- *Për këtë thirrje merret për bazë data e regjistrimit të biznesit nga sistemi i ARBK-së, dhe ajo datë e përcakton në cilin Lot mund të aplikoni.*

39. Jam ??? ???? 21vjeç nga Mitrovica dhe këto ditë jam duke planifikuar hapjen e biznesit për shërbime OPTIKE, Ju lus për sqjarim a përshtatet interesimi im për aplikim në këtë thirrje? A mundem me apliku?

- *Shiqo udhëzuesin për aplikantë piken 2.4.*

40. Kërkoj nga ana juaj sqarim lidhur me skemën programore të aplikimit për grante. Për vitin 2018 kemi qenë përfitues të një granti nga Ministria e Inovacionit në vlerë prej 10.000,00 € për hapje të biznesit të ri (Start-up) saktësisht hapja e një qerdheje për femijë. Mirëpo shpenzimet nuk janë mbuluar të gjitha dhe desha të di nëse mund të aplikojmë për Laminat dhe Sanitari apo vetëm për inventar?
- *Shpenzime të tilla nuk mbulohen as nga kjo thirrje për propozime shiqo udhëzuesin për aplikantë pikën 2.6 dhe 2.7;*
41. Pas shpalljes publike të thirrjes për aplikime nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, e në lidhje me skemën e granteve nga pika 3.4 informatat shtesë për plotësimin e formularit ju lutem të më plotësoni me informatat në vijim, A munden që aplikantët të jenë shoqëri aksionare?
- *PO, shiqo udhëzuesin për aplikantë pikën 2.1.*
42. A mundet që aplikantët të jenë shoqatat (në sektorin joqeveritar)?
- *JO.*
43. A mund të aplikohet për ndonjë makineri bujqësore?
- *JO.*
44. A mundet që edhe Komuna të jetë partner në projekt e përfitues të jetë firma ndërsa donator të jetë 80% Ministria e Zhvillimit Rajonal, ndërsa Komuna të financojë 20% me një letër përkrahjeje në aplikim?
- *JO*
45. Aplikuesi cili fiton grantin, a i bëhet transferi avans i mjeteve për blerjen e paisjeve të kërkuara, makinave për prodhim, apo ju po bëni blerjen? Ose ndryshe është parashikuar menaxhimi deri në realizimin e projektit në kuptimin e liferimit të pajisjeve të kërkuara?
- *Në rast se përfitoni grantin, MZHR do të paguaj pjesën e parë në avans varësisht se në cilin Lot aplikoni, kurse pjesa e dytë paguhet pas përfundimit të projektit. Bjerja e pajisjeve/makinerive apo shërbimeve është obligim i përfituesit.*
46. Ne jemi tre shokë që dëshirojmë të themelojmë një kompani mirëpo na duhen tri makina që janë të njejta për nga funksioni për të filluar aktivitetin në tri lokacione të ndryshme si dhe kështu të jemi partnerë të barabartë. Pyetje: A mund të aplikojmë të tre me llojin e njejtë të makinës dhe a duhet të jetë Profaktura në

emër të secilit veq e veq? A kemi të drejt që të marrim secili nga LOT 1, dhe pastaj t'i bashkojmë në një kompani të vetme apo jo?

- Nëse jeni biznes i regjistruar duhet të aplikoni në Lot përkatës ku për këtë thirrje merret për bazë data e regjistrimit të biznesit nga sistemi i ARBK-së, dhe ajo datë e përcakton në cilin Lot mund të aplikoni. Nëse nuk jeni të regjistruar ju mund të aplikoni ndaras por vlerësimet bëhen individuale për secilin aplikacion, kurse çështja e bashkimit të bizneseve është proces tjetër që duhet të konsultoheni me MTI/ARBK a mund ta bëni një gjë të tillë.

47. Deshta të ju pyes se a jepen grantet edhe për zhvillim rural, për shkak se jam duke punuar rreth hapjes së një restoranti në fshatin RAHOVICË komuna e Ferizajt dhe më duhen grante për shtrirjen e rrjetit elektrik rreth 600m, dhe shtrirjen e kanalizimit, 650m si dhe hapjen e një pusi 120m. Ju lutem të më konfirmoni se a mundet MZHR të më mbështet me një grant?

- Punët ndërtimore nuk financohen nga kjo thirrje për propozime shiqo udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4, 2.6 dhe 2.7.

48. Nëse një kompani e re është regjistruar në ARBK në Dhjetor të vitit 2018, a duhet të aplikojmë në LOT 1 apo LOT 2?

- Për këtë thirrje merret për bazë data e regjistrimit të biznesit nga sistemi i ARBK-së, dhe ajo datë e përcakton në cilin Lot mund të aplikoni.

49. Jam duke përgaditur dokumentacionin për aplikim për grant dhe oferta që kam marr tani për makineritë është në dollar. Desha të di a është e pranueshme kjo ofertë ku në formularin e aplikimit do ta konvertoja në euro, apo duhet ndërruar oferta?

- Duhet ta bashkangjitni kursin e valutës prej dollarit në euro në mënyrë që të keni përputhje me shumat e aplikimit.

50. Ne po mendojmë të aplikojmë për grant për: 1. Ndërtimin e punëtorisë dhe 2. Blerjen e makinës. I tërë projekti kushton afër 6000 euro. Ne kontribuojmë me 20% pra rreth 1000 euro dhe Ministria me rreth 5000 € në Lot 1. Ju lutem a pranohet përveq makinerisë edhe ndërtimi i punëtorisë-objekti?

- Punët ndërtimore nuk kualifikohen për këtë thirrje për propozime shiqo udhëzuesin për aplikantë 2.4, 2.6 dhe 2.7.

51. Nëse ne kemi nevojë për pajisje në vlerë 30,000 € ku nga autoriteti kërkojmë 25,000€ (80% e vlerës) përqindja e bashkëfinancimit tonë 20% (5,000 €) si total të del 30,000 €? Apo të dy vlerat duhet të llogariten dhe mos të kalojnë 25000€?

- 25,000.00 është maksimumi i vlerës së financimit (grantit) nga MZHR për Lot 3, d.m.th. kalkulimi bëhet: Granti+shuma e bashkëfinancimit = vlera e projektit.

52. A duhet të dorëzohen (online) edhe raportet e BQK personale dhe të biznesit para datës 22.02.2019 apo është vetëm për të përzgjedhurit?

- *Këto lloj raporte dorëzohen pasi të pai të parakualifikoheni por jo në këtë fazë.*

53. A duhet të dorëzohen (online) edhe qarkullimet bankare personale dhe të biznesit para datës 22.02.2019 apo është vetëm për të përzgjedhurit?

- *Këto lloj raporte dorëzohen pasi të parakualifikoheni jo në këtë fazë.*

54. A duhet të dorëzohen (online) ofertat e prodhuesit para datës 22.02.2019 apo është vetëm për të përzgjedhurit?

- *Oferta duhet të bashkangjitet kur të aplikoni shiqo udhëzuesin për aplikantë piken 3.1.*

55. Oferta e bashkangjitur në SMAED sistem, a duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nëse dërgohet paraprakisht nga ofertuesi me e-mail, apo mundet vetëm të dërgohet ashtu në PDF siç na është dërguar neve, apo duhet të kërkojmë nga Ofertuesi të na vulosë dhe të na nënshkruaj ofertën e tij.

- *Oferta mund të jetë me vulë dhe nënshkrim, por gjithsesi duhet ti ketë kontaktet e ofertuesit në mënyrë që vlerësuesit të kenë mundësi të verifikojnë ofertën.*

56. Jam i interesuar ta di se a kam të drejtë të aplikoj për një makinë për paketimin e mjaltit?

- *PO.*